


LegalNews

August 2022
Gusht 2022



Deloitte.

Ligji "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore"

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 58, datë 14.07.2022 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore" (në vijim "Ligji"), i cili rregullon krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore ("Parqet/Parku").

Ligji synon që nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të parqeve teknologjike dhe shkencore të realizojë nxitjen e zhvillimit të teknologjisë së lartë dhe inovacionit, kërkim-zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, dhe krijimin e vendeve të kualifikuara të punës për profesionistë të fushave të shkencës e teknologjisë.

I. Përkufizimi i "Parqeve" dhe krijimi i tyre

- Ligji përkufizon *Parku-n si një zonë ku integrohen struktura kërkimore e zhvillimore, në të cilën entitetet përdorin teknologji të avancuar në zhvillimin e produkteve ose shërbimeve apo të cilat investojnë në kthimin e shpikjeve teknologjike në produkte finale duke përfutur nga strukturat kërkimore të Parkut, dhe ka kuptimin e "zonës së lirë", sipas Kodit Doganor.*
- Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë miraton hapjen e një Parku si dhe kufijtë gjeografikë dhe llojet e veprimtarisë së përfshira.
- Zhvilluesi, i cili mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas

Law "On the creation, organization and operation of technology and science parks"

The Parliament of the Republic of Albania has approved Law no. 58, dated 14.07.2022 "On the creation, organization and operation of technology and science parks" (hereinafter, "Law"), which regulates the creation and operation of technology and science parks ("Parks/Park").

The Law aims that, through the creation and functioning of the technology and science parks, to develop high technology and innovation, the research and development of new products and services, and the improvement of existing ones, as well as the creation of qualified jobs for professionals in the fields of science and technology.

I. Definition of "Parks" and their creation

- The law defines the *Park as an area where research and development structures are integrated, in which entities use advanced technology in the development of products or services, or in which they invest in turning technological inventions into final products by benefiting from the research structures of the Park and has the meaning of "free zone", according to the Customs Code.*
- The Council of Ministers, with the proposal of the Ministry of Finance and Economy, approves the establishment of a Park as well as the geographical boundaries and the types of activities involved.
- The developer, who can be a natural or legal person, native or

ose i huaj, paraqet kërkesë për zhvillimin dhe administrimin e një Parku, dhe nëse përzgjidhet nga institucioni përkatës, lidh një marrëveshje ku ndërmerr angazhime reciproke.

- Zhvilluesi ka detyrimin të përfshijë në Park një institucion të arsimit të lartë vendas ose të huaj të akredituar, dhe të përzgjedhë përdoruesit e Parkut.
- Transferimi i një veprimtarie ekonomike ekzistuese në territorin shqiptar në Park është e ndaluar.

II. Veprimtaria e lejuar

Aktivitetet e lejuara në Park janë të kufizuara në aktivitetet e kërkim-zhvillimit dhe përfshijnë:

- Kërkim-zhvillimin me qëllim përfitimin e njohurive të reja teknologjike apo shkencore, të cilat mundësojnë zhvillimin e produkteve apo të shërbimeve;
- Krijimin e metodave të reja të prodhimit të produkteve apo të shërbimeve ose përdorimi i teknologjisë së avancuar në prodhimin e software-eve, në përpunimin e të dhënave apo në aktivitete të ngjashme;
- Përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve në një mënyrë që sjell ndryshim thelbësor, jo të një natyre estetike, në pjesë apo në funksion, krahasuar me produktet ekzistuese;
- Fokusimi në trajnimin e ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve, me qëllim angazhimin e tyre në prodhimin e produkteve dhe të shërbimeve inovative;

foreign, submits a request for the development and administration of a Park, and if selected by the relevant institution, enters into an agreement where the parties undertake mutual commitments.

- The developer has the obligation to include in the Park an accredited domestic or foreign higher education institution and to choose the users of the Park.
- The transfer of existing economic activities in the Albanian territory to the Park is prohibited.

II. Permitted activity

Activities allowed in the Park are limited to research and development activities and include:

- Research and development in order to benefit from new technological or scientific knowledge, which enables the development of products or services;
- Creation of new methods of production of goods or services, or using advanced technology in software production, data processing or similar activities;
- Improving products and services in a way that brings substantial change, not of an aesthetic nature, in part or function, compared to existing products;
- Focusing on training and increasing the capacities of professionals, in order to engage them in the production of innovative products and services;

- Këshilli i Ministrave mund të miratojë veprimtari të tjera të lejuara.

III. Të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore ose private

- Pasuritë e paluajtshme pronë shtetërore ku do të zhvillohet Parku merren me qira nga zhvilluesi për një periudhë kohe jo më pak se 20 (*njëzet*) vjet, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Marrëdhënia me pronarin e pasurive të tjera të paluajtshme pronë private duhet të përcaktohet nga zhvilluesi me pronarët përkatës përpara aplikimit të tij për shpalljen e Parkut.
- Zhvilluesi mund të japë me nënqira pasurinë e paluajtshme përdoruesve me të cilët do të lidhë kontratë.

IV. Lehtësitë fiskale

- Furnizimi i mallrave shqiptare, të cilat do të shërbejnë për nxjerrjen e 'produkteve inovative' do të konsiderohen si furnizim për eksport me shkallë 0 (*zero*), në përputhje me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe legjislacionin doganor.
- Norma e tatim fitimit do të jetë 0 (*zero*) për 15 (*pesëmbëdhjetë*) vite të njëpasnjëshme për të ardhurat që do të gjenerohen nga aktivitetet në Park.
- Stafi i përdoruesit që punon në kërkim-zhvillim si dhe i gjithë personeli i zhvilluesit, do të përjashtohet nga të gjitha taksat për një periudhë 10-vjeçare.

- The Council of Ministers can approve other permitted activities.

III. Rights over state or private immovable property

- State immovable property, where the Park shall be placed, is leased to the developer for a period of time not less than 20 (*twenty*) years, which is approved by a decision of the Council of Ministers.
- The relationship with the owner of other private immovable property must be determined by the developer with the respective owners before his application for the announcement of the Park.
- The developer can sublease the immovable property to users with whom it will enter into an agreement.

IV. Fiscal facilities

- The supply of Albanian goods, which will serve for the production of 'innovative products' will be considered as a supply for export with a 0 (*zero*) rate, in accordance with the legislation on value added tax and customs legislation.
- The income tax rate will be 0 (*zero*) for 15 (*fifteen*) consecutive years for the income that will be generated from activities in the Park.
- The staff of the user who shall work in the research and development as well as all the staff of the developer will be exempted from all taxes for a period of 10 years.

- Mallrat, shërbimet dhe pajisjet që do të përdoren në Park për nxjerrjen e 'produkteve inovative' do të përjashtohen nga TVSH-ja.
- Zhvilluesi dhe përdoruesit e Parkut do të përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, si dhe nga taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë 10-vjeçare, për ndërtime të realizuara në Park.
- Kostot e trajnimit për punonjësit shkencorë dhe teknikë në Park mund të rimbursohen pjesërisht nga shteti sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Lehtësitë fiskale si më sipër, do të pasqyrohen në kontratat përkatëse mes zhvilluesit dhe institucionit përgjegjës, si dhe mes zhvilluesit e përdoruesit/ve të Parkut.
- Rregullat e procedurat për hyrjen dhe daljen e mallrave dhe shërbimeve në/nga Parku, do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në ligjin nr.9789, datë 19.07.2007, "*Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik*".
- Shërbimet që ofrohen nga pjesa tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për subjektet brenda Parkut, përfitojnë të gjitha lehtësitë që zbatohen për eksportin e shërbimeve.
- Goods, services and equipment that will be used in the Park to produce 'innovative products' will be exempt from VAT.
- The developer and users of the Park will be exempt from the infrastructure impact tax, as well as from the real estate tax, for a period of 10 years, for the constructions carried out in the park.
- Training costs for scientific and technical workers in the Park may be partially reimbursed by the state in accordance with the criteria approved through a decision of the Council of Ministers.
- The aforesaid fiscal facilities will be reflected in the respective contracts between the developer and the responsible institution, as well as between the developer and the user/s of the Park.
- The rules and procedures for the entry and exit of goods and services to/from the Park will be the same as those defined in law no. 9789, dated 19.07.2007, "*On the creation and operation of technology and economic development zones*".
- Services offered by the rest of the customs territory of the Republic of Albania for entities inside the Park, shall benefit from all the facilities that apply to the export of services.

V. Lehtësi të tjera

- Zhvilluesit përfitojnë të njëjtat lehtësi si ato të parashikuara në nenin 21, të ligjit nr.55/2015, "*Për investimet strategjike në*

V. Additional facilities

- Developers benefit from the same facilities as the one stipulated in article 21, of law no. 55/2015, "*On strategic investments in the*

Republikën e Shqipërisë" ("**Ligji për Investimet Strategjike**"), me përjashtim të shpronësimit për interes publik.

- Këshilli i Ministrave miraton ndërtimin e infrastrukturës së përgjithshme sipas mundësive deri në kufijtë e Parkut.
- Kërkesat për leje dhe licenca nga zhvilluesi ose përdoruesi trajtohen nga autoritetet përkatëse brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditësh pune nga dorëzimi i kërkesës, sipas lehtësirave të ngjashme rregullatore të përcaktuara në Ligjin për Investimet Strategjike.
- Afati i sipërpërmendur, për shkaqe të arsyeshme, mund të shtyhet vetëm 1 herë, për një periudhë kohore prej 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditësh pune. Nëse institucionet apo autoritetet publike nuk shprehen edhe pas këtij afati të dytë, aprovimi konsiderohet i dhënë.

VI. Pronësia Intelektuale

- Pronësia intelektuale e krijimeve të zhvilluara në Park duhet të regjistrohet dhe me autoritetet përkatëse në Republikën e Shqipërisë.
- Zhvilluesi ka të drejtë të përfitojë një pjesë të të ardhurave që gjenerohet nga pronësia intelektuale, për një periudhë 5-vjeçare.

Ligji është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 114, datë 12.08.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij publikimi.

Republic of Albania" ("**Law on Strategic Investments**"), as amended, with the exception of expropriation for the public interest.

- The Council of Ministers approves the construction of general infrastructure, as possible, up until the boundaries of the Park.
- Permits and license requests from the developer or user are handled by the relevant authorities within 15 (*fifteen*) working days from the submission of the request, according to similar regulatory facilities, stated in the Law on Strategic Investments.
- The above-mentioned deadline, for reasonable reasons, can be postponed only once, for another period of 15 (*fifteen*) working days. If public institutions or authorities remain silent even after this second deadline, the approval is considered granted.

VI. Intellectual Property

- The intellectual property of the creations developed in the Park must be registered with the relevant authorities in the Republic of Albania.
- The developer has the right to benefit from a part of the income generated by the intellectual property, for a period of 5 years.

The Law is published in the Official Gazette No. 114, dated 12.08.2022 and entered into force 15 days after its publication.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj

Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.